

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga SVAP Holdings doo Beograd (Vraçar), me seli në rr. Vojislava Iliq nr. 8, kati 4, banesa nr. 12, Beograd (Vraçar), Serbi, dorëzuar përmes, Avokatit Filip Zafirovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 16.06.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin SVAP Holdings doo Beograd (Vraçar), me seli në rr. Vojislava Iliq nr. 8, kati 4, banesa nr. 12, Beograd (Vraçar), Serbi, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi UMBRELLA CORPORATION LTD. SHPK BEOGRAD (SAVSKI VENAC) rruga Cara Iraklija numër 20, Beograd, Serbi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 08.04.2026, dhe plotësuar më datë 14.04.2026, 16.04.2026, 30.04.2026 dhe 29.05.2026 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e SVAP Holdings doo Beograd (Vraçar), me seli në rr. Vojislava Iliq nr. 8, kati 4, banesa nr. 12, Beograd (Vraçar), Serbi, me të cilin SVAP Holdings doo Beograd synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi UMBRELLA CORPORATION LTD. SHPK BEOGRAD (SAVSKI VENAC) rruga Cara Iraklija numër 20, Beograd, Serbi.

Komisioni filloi me shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim, plotësimit dhe shtojcave të tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

SVAP Holdings doo Beograd është shoqëri tregtare e cila për momentin nuk kryen asnjë aktivitet afarist, e themeluar më 29 dhjetor 2025.

SVAP Holdings doo Beograd nuk ka shoqëri të lidhura, përfaqësi ose filiale, dhe as nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SVAP Holdings doo Beograd (Vraçar) synon të fitojë 100% të pjesës në shoqërinë tregtare UMBRELLA CORPORATION LTD. SHPK BEOGRAD (SAVSKI VENAC) dhe në këtë mënyrë të fitojë kontroll ekskluziv mbi grupin e shoqërive tregtare ("Grupi Umbrella") i cili përbëhet nga:

1. UMBRELLA CORPORATION LTD. SHPK BEOGRAD,
2. AMBRELA KORPORACIJA SHPK Shkup, shoqëri tregtare e cila është themeluar dhe vepron në pajtim me rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli të regjistruar në adresën rr. Divizioni i 50-të nr. 24, Shkup, me veprimtari të regjistruar: 47.120 – Tregti tjetër me pakicë e pa specializuar.
3. UMBRELLA CORPORATION BH SHPK, shoqëri tregtare e cila është themeluar dhe vepron në pajtim me rregulloret e Bosnje dhe Hercegovinës, me seli të regjistruar në adresën Stefana Nemanje nr. 17, Llukavicë, Sarajeva Lindore e Re (Istočno Novo Sarajevo), Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe
4. UMBRELLA CORPORATION CG SHPK Podgoricë, shoqëri tregtare e cila është themeluar dhe vepron në pajtim me rregulloret e Malit të Zi, me seli të regjistruar në adresën Zyra e agjencisë së kontabilitetit "Perfectum", Branka Deletiq p.n., lamela H, Podgoricë, Mali i Zi.

Grupi Umbrella merret me importin, eksportin, shitjen me pakicë dhe shitjen me shumicë të çakmakëve, nargjileve dhe produkteve alternative të duhanit, përkatësisht produkteve të gjeneratës së re: cigare elektronike njëpërdorimshme dhe shumëpërdorimshme, lëngje për mbushjen e cigareve elektronike, aroma për nargjile dhe qese nikotine, në territorin e Republikës së Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me prodhimin, përkatësisht përpunimin e mëtejshëm të lëngjeve për mbushjen e cigareve elektronike në territorin e Republikës së Serbisë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ